

VENDIM
Nr.67, datë 1.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SHPK

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1).
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Paraqitjen e oponencës teknike të projektit është shoqëruar me informacionin për fillimin e punës për hartimin e saj (informacion i paraqitur nga aplikuesi dhe shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, METE, nr.6294/3, prot., datë 10.8.2009).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Ashta”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta